



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GILAN BELEDIYESI

## Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 27.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1.1 pika (a) të lidhur me nenin 62.1 pika (d) të Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 24.07.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “RSM COMPANY” SH.P.K. për aktivitetin e prokurimit me titull: “*Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore në komunën e Gjilanit*” me Nr. të Prok: 651-22-10313-2-1-1, mori këtë:

### VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar Kërkesa për rishqyrtim e Operatori Ekonomik “RSM COMPANY” SH.P.K. me seli në Prishtinë e parashtruar me datë 24.07.2023 kundër Njoftimit për Vendimin të AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “*Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore në komunën e Gjilanit*” me Nr. të Prok: 651-22-10313-2-1-1, inicuar nga AK Komuna e Gjilanit.
- II. **VËRTETOHET** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i dt. 21.07.2023 për aktivitetin e prokurimit “*Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore në komunën e Gjilanit*” me Nr. të Prok: 651-22-10313-2-1-1, dhe AK – Komuna e Gjilanit vendsosë të vazhdojë më tutje me procedurën e prokurimit të përcaktuar si në pikën një dhe dy të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “RSM COMPANY” SH.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik “RSM COMPANY” SH.P.K. si palë e pakënaqur me datë 24.07.2023 ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim në AK- Komunën e Gjilanit kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të dt. 21.07.2023 duke e atakuar vetëm Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar RSM COMPANY” SH.P.K përkitazi me aktivitetin e prokurimit me titull: “*Sinjalizimi Horizontal, Vertikal dhe pajisjeve rrugore në komunën e Gjilanit*” me Nr. të Prok: 651-22-10313-2-1-1, me arsyetimin se i ka plotësuar të gjitha kriteret e dosjes së tenderit, prandaj edhe ka kërkuar rishqyrtimin e vendimit.

Me rastin e vlerësimit preliminar të Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruesit, Autoriteti Kontraktues ka gjetur se kërkesa në rastin konkret është parashtruar brenda afatit ligjor nga personi i autorizuar sipas paragrafit 3.2 të nenit 108/A të LPP-së dhe nenit 60.2 – b) të Rregullorës për Prokurim Publik Nr.001./2022. Nga ana tjetër është gjetur se parashtruesi i kërkesës nuk mund ta ketë statusin e palës me interes në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së dhe Informatës së publikuar nga OSHP me dt.02.02.2023, sepse edhe sikur hipotetikiqisht të kthehej lënda në rivlerësim nuk mund të dëshmojë interes material nga rezultati i këtij aktiviteti për arsye nuk ka atakuar dhe paraqitur argumente se OE tjerë të radhitur para tij nuk janë të përgjegjshëm të cilët edhe janë më të lirë për nga çmimi.

Megjithatë, duke u nisur nga parimet e vlerësimit objektiv, transparent dhe të barabartë në mënyrë që të eliminojmë çdo mundësi të rrethanave që mund të rezultojë në diskriminim karrshi OE ankues, AK ka vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) pretendimeve të evidentuara në kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

Në këtë mënyrë, pas trajtimit dhe shqyrtimit meritor të pohimeve të OE ankues të parashtruara në kërkesën për rishqyrtim në relacion me të gjitha faktet, provat materiale dhe shkresave të lëndës të administruara, rezulton se, **pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara dhe pa ndikim për vendosje ndryshe** sepse AK me rastin e rivlerësimit të tenderëve ka vendosur në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit duke zbatimit të drejtë e të ligjshëm të nenit 59 paragrafi 4 dhe nenit 60 paragrafi 1.1 të LPP-së lidhur me dispozitat tjera të zbatueshme në këtë rast.

#### **- Administrimi dhe vlerësimi i Fakteve dhe rrethanave të rastit –**

AK – Komuna e Gjilanit, gjatë procesit të rivlerësimit të tenderëve ka vërejtur se oferta e juaj nuk e ka përmbushur në tërësi kërkesat e AK-së, konkretisht kapacitetet teknik dhe profesionale të specifikuar në pikën III.2.4) të Njoftimit për Kontratë dhe kërkesën nr. 1 të nenit 9.1 & 9.2 në FTD të dosjes së tenderit.

Në kriterin e kapacitetit teknik dhe profesional të ofertës, nenin 9.1&9.2 të FTD-së, Kërkesa nr. 1 është specifikuar se: *Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme (furnizim me shenja, sinjalistike,ndertim të semaforeve) gjate 3 vitet e fundit.*

*Në një vlere prej jo me pak se 450.000,00 €.*

Për ta dëshmuar se OE i posedojnë kualifikimet e specifikuar në dosjen e tenderit lidhur me kërkesën në fjalë janë kërkuar dëshmitë dokumentare si në vijim:

**Dëshmia 1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten:**

(i) kur shërbimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata /raport pranimi/ reference) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë. të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar.

(ii) kur shërbimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e transkasionit banker.

Gjatë procesit të rivlerësimit të tenderëve AK-ja, ka vërejtur se dëshmitë dokumentare që i keni bashkëngjitur në ofertën e juaj nuk e plotësojnë në tërësi kërkesën e AK-së me nr. 1 të specifikuar në nenin 9.1&9.2, të FTD-së së dosjes së tenderit bazuar në arsyet e renditura si në vijim:

**Sipas referencës me numër protokollit 5607 të datës 28.07.2020 për punët e realizuara në shumën prej 208,838.17€, rezulton se nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë (30.09.2022) deri te përfundimi i punëve me datë 21.06.2019 ka kaluar periudha prej tri (3) vite, tre (3) muaj e dhjetë (10) ditë.**

Sipas listës së kontratave të realizuara në tri vitet e fundit është evidentuar përfundimi i punimeve prej 250,964.53€ në projektin “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët nacionale dhe rajonale në Republikës së Kosovës për Lot V për vitet 2020-2021” mirëpo ka munguar referenca për punët përkatëse.

**Sipas Raportit Përfundimtar të punëve të kryera në kontratën “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët nacionale dhe rajonale në Republikës së Kosovës për Lot V për vitet 2020-2021” me numër prokurimi MI/17/061/511, në pikën 5 DËSHMIT MBI KUALITETIN E PUNËVE TË REALIZUARA është evidentuar se nuk është bërë çertifikimi dhe testimi punëve, konkretisht ekzaminimet laboratorike për disa pozicione që lidhen me kualitetin dhe cilësinë e punëve dhe materialeve me arsyetimin se MI nuk ka kontratë për realizimin e këtyre testeve. Për më tepër ky raport nuk është i bashkë-nënshkruar dhe vulosur nga menaxheri i projektit të AK-së që e ka lëshuar ashtu siç është kërkuar në Aneksin 6 të dosjes së tenderit dhe përcaktohet në nenin 69 paragrafi 4.2 i LPP-së.**

Prandaj, për të eliminuar çdo mundësi të kufizimit të konkurrencës dhe diskriminimit në relacion me ofertën e juaj dhe për të lehtësuar egzaminimin, bazuar marrë në konsideratë qëllimin e nenit 1 të LPP-së dhe duke u mbështetur në praktikat më të mira në prokurim publik të trajtimit të barabartë, AK përmes kërkesës për sqarim të tenderit të datës 10.07.2023 ju ka krijuar mundësinë që brenda një afati t’ a bëni sqarimin dhe plotësimin e tenderit përkitazi me dokumentet e lartcekura për të pasqyruar gjendjen ekzistuese para publikimit të njoftimit për kontratë, por pa i ndryshuar kushtet materiale dhe aspektet e tenderit.

Nëpërmjet përgjigjes të cilën e keni kthyer me datën 11.07.2023 në kuadër të kontratave të realizuara nga ana e juaj keni bashkëngjitur dëshmi lidhur me projektin me titull: “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët nacionale të Kosovës Lot 5 2018/2019” dokumentet e renditura si në vijim: Referenca Nr. prot 5607 e dt. 28.07.2020 për punët e realizuara në vitin 2018/2019 në vlerë totale prej 208,838.17€; Referenca Nr. prot 5606 e dt. 28.07.2020 për punët e realizuara në vitin 2019/2020 në vlerë totale prej 205,950.59€; Referenca Nr. prot 3621 e dt. 12.04.2023 për punët e realizuara në vitin 2020/2021 në vlerë totale prej 250,964.53€; Raportin Përfundimtar të menaxherit të projektit të dt. 23.06.2021 (pa nënshkrim dhe pa vulë) si dhe kontratën nr. protokollit 6223 për aktivitetin e njejtë.

Autoriteti Kontraktues, pasi që i ka analizuar dhe shqyrtuar dokumentet të cilat i keni paraqitur përmes përgjigjes për sqarimin e ofertës tuaj, duke i analizuar të njejtat edhe në relacion me shkresat tjera të ofertës së juaj si dhe në relacion me kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit, bazuar në përgjithësi në dosjen e juaj përfshirë edhe sqarimin dhe plotësimin shtesë të saj, ka ardhur në përfundim se, oferta e juaj NUK KALON në kuptim të nenit 59.4 lidhur me nenin 69 par. 4.2 të LPP-së sepse nuk e plotëson kriterin e kapacitetit teknik dhe profesional siç është kërkuar në pikën III.2.4) të Njoftimit për Kontratë dhe kërkesën nr. 1 të nenit 9.1 & 9.2 në FTD-së.

Gjetjet dhe konstatimet e lartcekura, AK i mbështet në vlerësimin e evidentuar në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar RSM COMPANY” SH.P.K të dt. 21.07.2023 si dhe vlerësimin dhe administrimin e dokumenteve shtesë të dorëzuara nga OE ankues përmes mundësisë së sqarimit të tenderit, bazuar në arsyet e renditura si në vijim:

1. Referenca me numër protokoli 5607 e datës 28.07.2020 për projektin “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët nacionale dhe rajonale në Republikës së Kosovës për Lot V për vitet 2020-2021” në vlerën e punëve të realizuara prej 208,838.17€, nuk e përmbush kërkesën nr.1 të nenit 9.1&9.2 të FTD-së të dosjes së tenderit për arsye se punët e realizuara sipas kësaj reference e tejkalojnë afatin e kërkuar gjatë 3 viteve të fundit në relacion me datën e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Njoftimi për Kontratë është bërë publik me datë 30.09.2022, kurse sipas referencës të lartcekur punët kanë përfunduar me datë 21.06.2019 dhe në këtë mënyrë rezulton se, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë (30.09.2022) deri te përfundimi i punëve sipas referencës (21.06.2019) ka kaluar periudha prej tri (3) vite, tre (3) muaj e dhjetë (10) ditë.

Prandaj referenca nr. 5607 nuk e përmbush kërkesën AK-së sepse punët sipas kësaj reference nuk janë të përfunduara brenda tri viteve të shkuara nga data e njoftimit për kontratë dhe në këtë mënyrë kjo referencë nuk i plotëson as kërkesat ligjore sipas nenit 69 paragrafi 4.2 të LPP-së lidhur me nenin 8.5 shkronja iii) të Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik.

2. Referenca me numër protokoli 3621 e datës 12.04.2023, lidhur me projektin “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët nacionale dhe rajonale në Republikës së Kosovës për Lot V për vitet 2020-2021” në vlerën e punëve të realizuara prej 250,964.53€, e cila nuk ka qenë pjesë e ofertës tuaj, por është dorëzuar me datën 11.07.2023 përmes përgjigjes për sqarimit e tenderit, nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit përfshirë Aneksin 6 dhe kërkesat ligjore, sepse data e lëshimit të kësaj reference (12.04.2023) është një muaj e gjashtë ditë pas kalimit të afatit të dorëzimit të ofertave ,ku afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë datë 06.03.2023. Në asnjë rrethanë nuk duhet t’i bartet pasoja AK dhe OE tjerë pjesëmarrës për shkak se të papërgjegjshësisë apo dështimit të juaj që të dorëzoni dokumentacionin e plotë sipas kërkesave të dosjes së tenderit brenda afatit kohor për dorëzimin e tenderëve ashtu siç ishte përcaktuar në Njoftimin për Kontratë dhe dosjen e tenderit. Sipas kuptimit ligjor të prokurimit “afatet kohore për dorëzimin e tenderit” kanë karakter obligativ. Prandaj në pikpamje ligjore nuk mund të krijohet një efekt prapaveprues (retroaktiv) me një dokument si ky ekzistenca e të cilit nuk ka qenë para datës së dorëzimit të ofertave, por është lëshuar një muaj e gjashtë ditë pas datës së hapjes së ofertave. Sepse tendenca për të kërkuar njohjen e një të drejte për të krijuar favore në kundërshtim me rregullat e procedurës dhe bazën ligjore në fuqi është e kundërligjshme dhe krijon pasiguri juridike, efekt diskriminues dhe shtrembërim të konkurrencës në relacion me OE tjerë, ofertimet e të cilëve janë në pajtueshmëri me dispozitat e legjislacionet për prokurim publik.

3. Arsyetimi i juaj se një referencë mund të lëshohet edhe “pas 5 apo 10 viteve” nuk është kontestues mirëpo ajo nuk mund të ketë efekt prapaveprues por mund të jetë valide apo e vlefshme vetëm nëse është brenda tri viteve të shkuara nga data e njoftimit për kontratë. Po ashtu, e njejta është në kundërshtim edhe me listën e kontratave për shkak se me rastin e dorëzimit të ofertës tuaj ,nuk ka qenë e bashkëngjitur dhe duke qenë se e njejta nuk ka qenë e bashkëngjitur me Aneksin 6 - i) ku decidivisht është parashikuar se: “kur sherbimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata /raport pranimi/ reference) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë...

Prandaj, duke ju referuar paragrafeve të lartëcekura AK, konstaton se dëshmia e ofruar nga jua nuk e plotëson kërkesën e AK-së..

4. **Raporti Përfundimtar i punëve të kryera në kontratën “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët nacionale dhe rajonale në Republikës së Kosovës për Lot V për vitet 2020-2021”** me numër prokurimi MI/17/061/511, i cili i referohet kontratës me nr. 44/2018, i cili në verzionin e njejtë (pa nënshkrim dhe pa vulë) është dorëzuar së bashku me ofertën e juaj me të cilën keni ofertuar dhe pastaj përmes përgjigjes për sqarim të tenderit, nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e dosjes së tenderit si dhe bazën ligjore lidhur me nenin 69 paragrafi 4.2 të LPP-së dhe nenin 40.6 -a) të RRPP Nr.001/2022.

#### **Provë pjesa e fundit e raportit në fjalë:**

##### **Raportin e përgatiti:**

1. Menaxher i Projektit (Ministria e Infrastrukturës) - Emir Morina, Ing. i dipl.
2. Menaxher nga ana e Operatorit Ekonomik “RSM Company” SH.P.K. - Liridon Shahini, Ing. i dipl.

**Së pari**, në kontekstin faktik raporti në fjalë nuk është në pajtueshmëri me kërkesat formale të dosjes së tenderit, konkretisht me udhëzimet e Aneksit 6 i cili ndër tjera përcakton se, **raporti duhet të jetë i bashkë-nënshkruar nga autoriteti i tillë publik (që e ka lëshuar)**. Dhe duke qenë se nuk është në pajtueshmëri me kërkesat formale të dosjes, rrjedhimisht edhe në kontekstin ligjor është në kundërshtim thelbësor me Rregullorës Nr.001/2022 për Prokurim Publik në nenin 40.6 pika (a) e i cili përcakton se:

**Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:**

- a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;

**Së dyti**, sipas pikës 1.5 të këtij raporti rezulton se raporti, ju ka referuar punëve të pjesshme të realizuara në shumën prej 250,964.53€ ashtu siç është evidentuar në referencën nr. protokolli 3621 e cila është lëshuar me datë 12.04.2023, një muaj e gjashtë ditë pas afatit të dorëzimit të ofertave.

**Së treti**, sipas pikës 5 DËSHMIT MBI KUALITETIN E PUNËVE TË REALIZUARA rezulton se nuk është bërë certifikimi dhe testimi punëve, konkretisht ekzaminimet laboratorike për disa pozicione që lidhen me kualitetin dhe cilësinë e punëve dhe materialeve me arsyetimin

se MI nuk ka kontratë për realizimin e këtyre testeve. Prandaj, në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara në pikën 5 të raportit, rezulton se lidhur me projektin si më sipër nuk është bërë çertifikimi përfundimtar i pranimit të punëve nga ana e AK përkatës.

### **Provë pika 5 e raportit në fjalë:**

#### **5. DËSHMIT MBI KUALITETIN E PUNËVE TË REALIZUARA**

Edhe pse sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve është një lëmi specifike dhe disa nga pozicionet kanë nevojë për ekzaminime laboratorike, kjo nuk ka mundur të realizohet sepse Ministria e Infrastrukturës nuk ka lidhur ndonjë kontratë për realizimin e këtyre testeve. Megjithatë vërtetimi i punëve në mënyrë sasimore është bërë në mënyrë të rregullt.

Bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara si më sipër, ky raport është jo valid sepse është dorëzuar në verzionin e panënshkruar dhe vulosur nga autoriteti i tillë publik dhe nga ana tjetër sipas konstatimeve të evidentuara në pikën 5 nuk mund të dëshmon çertifikimin përfundimtar të punëve. Prandaj si i tillë nuk e përmbush kriterin e dosjes së tenderit në kërkesën nr. 1 të nenit 9.1&9.2 të kapacitetit teknik dhe profesional të dosjes.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues sa i përket raportit të kontestuar pa nënshkrim dhe pa vulë, se sipas parashtruesit të kërkesës AK ka paragjykuar dhe se nuk ka kërkuar sqarime nga OE ankues dhe zyrtarët e MI-së sipas kontakteve të evidentuar në raport, ju sqarojmë se pretendimet e juaja janë të pabazuara dhe në kundërshtim me rrethanat e gjendjes faktike dhe juridike. Së pari, AK për ta qartësuar ofetën e juaj dhe duke e përfshirë edhe këtë çështje, me datën 10.07.2023, ju ka kërkuar sqarim dhe plotësim të ofertës sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së. Nga ana e juaj me datën 11.07.2023 përmes përgjigjes sqaruese e keni bashkëngjitur verzionin e raportit të njejtë, pa nënshkrim dhe pa vulë nga autoriteti i tillë publik – MI. Prandaj justifikimet e juaja janë supozime të pabaza sepse nuk mbështetet me asnjë argument të qëndrueshëm dhe bazuar që e provon pretendimin e juaj. Ndërsa sa i përket bashkëngjites në kërkesë për rishqyrtim të raportit të njejtë në verzionin e nënshkruar (pa vulë), ju sqarojmë se ne si AK ju kemi dhënë mundësinë për sqarimin dhe plotësimin e ofertës tuaj duke përfshirë edhe këtë aspekt. Megjithatë, ju keni dështuar që brenda afatit kohor të specifikuar në kërkesën për sqarim të ofertës t'a plotësoni dhe kompletioni këtë dokument në verzionin e bashkë nënshkruar dhe vulosur sipas kërkesave dhe rregullave të procedurës. Prandaj, për shkak të dështimit të juaj ne si AK nuk mund të pranojmë si valid asnjë dokument çfarëdo qoftë ai pas afateve kohore që kanë qenë të specifikuara në dokumentet e tenderit dhe që e kanë karakterin obligativ ligjor sepse ndryshohet kushti material në dëm të OE tjerë që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm duke respektuar afatet procedurale dhe se një veprim i tillë do të paraqiste shkelje të rëndë ligjore nga ana jonë. Po ashtu ju sqarojmë se AK ka kërkuar për të sqaruar ofertën e juaj dhe aspekte tjera të ofertës ashtu siç kemi vepruar në rastin konkret përmes kërkesës për sqarime.

**- Përfundim -**

Autoriteti Kontraktues pas shqyrtimit meritor të gjitha pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të OE RSM COMPANY Sh.p.k., dhe duke u bazuar në analizën e të gjitha fakteve dhe shkresat e kësaj lënde, sipas vlerësimit të pavarur dhe objektiv konstaton se pretendimet e evidentuara në kërkesën e juaj janë të pabazuara në tërësi dhe në këtë mënyrë kërkesa e juaj refuzohet në të gjitha pikat si e pabazuar.

Në këtë mënyrë, AK vlerëson se procesi i rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve është zhvilluar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe zbatimit në mënyrë të drejtë të nenit 59.4, nenit 60 paragrafi 1.1 lidhur me nenin 69 paragrafi 4.2 si dhe me nenin 1, 6 dhe 7 të LPP-së.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart, Autoriteti Kontraktues përmes Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit në kuptim të nenit 108/A në paragrafin 10.1 të LPP-së dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1.1 pika (a) të lidhur me nenin 62.1 pika (d) të Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

  
Krijan Bajrami  
Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit

**Kopje:**

- Operatorit Ekonomik;
- Zyrës së Kryetarit të Komunës;
- Te gjitha palëve të interesuara;

**KËSHILLA JURIDIKE:**

*Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqesë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.*